



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

AGROBIZNES

Niveli i katërt në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

H/1-IV-22

Tiranë 2022

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

²Korniza Evropiane e Kualifikimeve

| Emërtimi i kualifikimit | AGROBIZNES | | | Kodi |
|--|--|--------|--|-----------|
| Kohëzgjatja | 3800-4200 orë | Niveli | IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK | H/1-IV-22 |
| Qëllimi: | Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në kualifikimin profesional “Agrobiznes”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK, është përgatitja e individëve në nivelin teknikut të mesëm për bujqësi tradicionale dhe organike për t’u punësuar në fushën e bujqësisë në institucione / ndërmarrje shtetërore / private apo për krijimin e menaxhimin e një biznesi privat, si person fizik ose juridik dhe. zhvillimi i personalitetit të tyre për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon. | | | |
| Kriteret e përgjithshme të pranimit: | Në institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional, që ofrojnë kualifikimin profesional “Agrobiznes”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional. | | | |
| Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit: | Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikim profesional “Agrobiznes”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK, individit pajiset me Certifikatën e aftësisë profesionale të teknikut të mesëm në këtë fushë dhe suplementin përkatës, që njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si menaxher i mesëm në ferma bujqësore, në ferma blegtorale, në ferma të prodhimit organik, në impiante të kultivimit të peshkut dhe midhjeve, në njësi ekonomike të bletarisë, njësi ekonomike të agroturizmit, në njësi ekonomike të kultivimit të bimëve mjekësore dhe aromatike, njësi ekonomike të bimëve zbukuruese dhe luleve; shoqata e bashkëpunimit bujqësor, dhe/apo të vetëpunësohet në sektorin e bujqësisë tradicionale dhe organike. Me përfundimin e këtij kualifikimi profesional, individit ka mundësi për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare. | | | |
| Data e validimit | <i>Shkurt 2023</i> | | | |
| Data e miratimit | | | | |
| Variantet mëparshme | | | | |

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Agrobiznes” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV në KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë profesionale si më poshtë:

Organizimi dhe menaxhimi i prodhimit bujqësor

- Të përshkruajë zhvillimet në fushën e bujqësisë;
- Të përshkruajë kuadrin rregullator në fushën e bujqësisë;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e planifikimit të burimeve dhe aktiviteteve bujqësore;
- Të argumentojë planin e qarkullimit të kulturave bujqësore;
- Të shpjegojë mënyrat e organizimit të punës në prodhimit bujqësor;
- Të shpjegojë mënyrat e mbikëqyrjes/monitorimit të proceseve të punës në bujqësi;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e menaxhimit të burimeve njerëzore të punës në bujqësi;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e menaxhimit të burimeve materiale dhe financiare të punës në bujqësi;
- Të argumentojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës në përputhje me planifikimet e kryera të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;
- Të tregojë rëndësinë e përgatitjes dhe sistemimit të vendit të punës për proceset bujqësore të planifikuara;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes dhe sistemimit të materialeve, mjeteve të punës dhe pajisjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
- Të përshkruajë llojet e solucionave pastruese dhe mënyrat e përdorimit të tyre;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e plotësimit dhe ruajtjes së dokumentacionit të punës.

Makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet në bujqësi

- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave mbi higjienën personale dhe të makinerive dhe pajisjeve në bujqësi;
- Të klasifikojë llojet e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjet në bazë të procesit të punës.
- Të përshkruajë gatishmërinë teknike dhe konfigurimin e nevojshëm të makinerive, mjeteve të punës, pajisjeve, veglave dhe agregateve;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve për përpunime të thjeshta të produkteve bujqësore dhe blegtorale;

- Të interpretojë kalendarin e shërbimeve të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë llojet e shërbimeve dhe teknikat e mirëmbajtjes sipas llojit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë procedurat për ruajtjen dhe magazinimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve gjatë kohës që nuk përdoren;
- Të shpjegojë mënyrat e dezinfektimit të mjeteve dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të interpretojë llojet e defekteve të thjeshta në makineri, mjete pune dhe pajisje bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë llojet dhe teknikat e riparimeve të thjeshta në makineri, mjete pune dhe pajisje bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë mënyrën e regjistrimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve sipas proceseve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe teknikat e kolaudimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve sipas proceseve të punës.

Mekanizimi i prodhimit bimor

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve në prodhim bimor;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për punimin bazë të tokës;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për punime përgatitore të tokës për mbjellje;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për mbjellje;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për shërbimet agroteknike;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për vjelje, korrje, shirje dhe kositje;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për grumbullim dhe transport;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive bujqësore, mjeteve të punës dhe pajisjeve për përpunim paraprak.

Mekanizimi i prodhimit blegtoral

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve në prodhim blegtoral;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve për pastrimin dhe higjienizimin e komplekseve blegtorale;

- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve për higjienizimin dhe mirëmbajtjen e kafshëve;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve për grumbullimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit blegtoral;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve për fiksimin e kafshëve;
- Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve për mjeljen e kafshëve;

Faktorët agropedologjikë dhe klimatikë për prodhimin bujqësor

- Të përshkruajë llojet e tokave dhe karakteristikat e tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e marrjes së mostrave të tokës dhe ujit, si dhe teknikat e mostrimit;
- Të listojë llojet e analizave fizike-kimike dhe biologjike të tokës dhe mënyra e interpretimit të tyre;
- Të analizojë të dhënat agrometeorologjike dhe agroekologjike gjatë planifikimit;
- Të analizojë kushtet hidrologjike për të përzgjedhur llojet dhe varietetet e kulturave bujqësore për kultivim;
- Të shpjegojë rëndësinë e masave për parandalimin e ndikimit të kushteve të pafavorshme agrometeorologjike (si p.sh., reshjet e shiut, temperaturat e ulëta, temperaturat e larta, thatësira, era, etj.);
- Të listojë masat e përshtatshme në procesin e prodhimit për shkak të ndryshimeve klimatike;
- Të shpjegojë mënyrën e funksionimit të sistemeve të sistemimit dhe kullimit të tokave.

Prodhimi i kulturave perimore dhe bimëve të arave

a) Kultura perimore

- Të dallojë llojet e kulturave perimore sipas teknologjive të kultivimit të tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të kultivimit të kulturave perimore;
- Të përshkruajë vlerat ushqyese e kurative të kultivimit të kulturave perimore;
- Të shpjegojë ndikimin e faktorëve klimatikë dhe tokësorë në përhapjen e kulturave perimore;
- Të klasifikojë kulturat perimore sipas kërkesave ndaj faktorëve klimatiko-tokësorë;
- Të listojë veçoritë kryesore për kultivimin e kulturave perimore;
- Të shpjegojë mënyrat e shtimit të kulturave perimore;
- Të rendisë kriteret dhe kërkesat për ndërtimin e mjediseve të mbrojtura dhe ndërtimin e tyre (vllaja, shtretër, tunele, serra);
- Të përshkruajë mënyrat e përgatitjes dhe dezinfektimit të dherishtes;
- Të shpjegojë mënyrat e punimit dhe përgatitjes të tokës;

- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit të kulturave perimore;
- Të shpjegojë masat e kujdesit të bimëve në përputhje me teknologjitë e kultivimit të kulturave perimore në mjedise të mbrojtura ose në fushë;
- Të shpjegojë teknologjitë e reja të kultivimit hidroponik, aeroponik dhe akuaponik;
- Të analizojë rëndësinë e përdorimit të plehërimit organik dhe të plehërimit të gjelbër për kultivimin e kulturave perimore;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e plotësimit të nevojave ushqyese të bimëve;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe teknikat e shartimit të kulturave perimore;
- Të përshkruajë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të kulturave perimore;
- Të shpjegojë metodat agroteknike për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të shpjegojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes, seleksionimit, ambalazhimit, transportimin dhe ruajtjen e magazinimit e produkteve të kulturave perimore.

b) Kultura bimët e arave

- Të dallojë llojet e bimëve të arave dhe veçoritë e teknologjive të kultivimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e punimit dhe përgatitjes të tokës;
- Të përshkruajë llojet, teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve mjekësore dhe aromatike;
- Të shpjegojë shërbimet ndaj bimëve në përputhje me teknologjitë e kultivimit të kulturave perimore në mjedise të mbrojtura ose në fushë;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e plotësimit të nevojave ushqyese të bimëve;
- Të përshkruajë llojet dhe teknologjitë e kultivimit të bimëve zbukuruese dhe luleve;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të kultivimit të bimëve të arave;
- Të klasifikojë bimët e arave sipas përshtatjes dhe faktorëve klimatiko-tokësorë;
- Të përzgjedhë kultivarët e përshtatshëm sipas destinacionit të përdorimit në bujqësi;
- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit të bimëve të arave;
- Të analizojë rëndësinë e përdorimit të plehërimit organikë e të plehërimit të gjelbër në kultivimin e drithërave,
- Të shpjegojë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të bimëve të arave;
- Të rendisë metodat e ndryshme agroteknike për kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të shpjegojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes, seleksionimit, ambalazhimit, transportimin dhe ruajtjen e magazinimit e produkteve të bimëve të arave.

Prodhimi i bimëve shumëvjeçare

a) Frutikulturë

- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike, të kultivimit të kulturave drufrutore;
- Të shpjegojë ndikimin e faktorëve klimatikë dhe tokësorë në përhapjen e pemëve

frutore, ullinje dhe agrumeve;

Të përshkruajë procedurat për ngritjen e plantacioneve në përputhje me standardet dhe teknologjinë bashëkohore të prodhimit.

- Të listojë anët pozitive dhe negative të shtimit me farë dhe me pjesë vegetative;
- Të shpjegojë teknikat e shtimit natyror dhe artificial në pemët frutore të ullirit dhe agrumeve;
- Të argumentojë rëndësinë e shartimit të kulturave drufrutore;
- Të rendisë kushtet klimatike dhe teknologjike për ngritjen e fidanishtes;
- Të përshkruajë organizimin e sektorit të shtimit dhe formimit të kulturave drufrutore;
- Të rendisë elementët kryesorë të organizimit të territorit të drufrutorëve;
- Të përshkruajë hapat teknologjikë të kultivimit në drufrutorë;
- Të argumentojë rëndësinë e shërbimeve agroteknike në drufrutorë;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e përdorimit të kufizuar të herbicideve, pesticideve në ruajtjen e tokës nga ndotja kimike;
- Të analizojë rëndësinë e plehërimit organik, mineral dhe të gjelbër në pemëtore;
- Të përshkruajë rëndësinë e krasitjes së drufrutorëve të rinj dhe drufrutorëve në prodhim;
- Të shpjegojë llojet dhe teknikat e krasitjeve në pemët frutore, ullinje, agrumeve;
- Të vlerësojë dëmin e shkaktuar nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm, si dhe metodat e ndryshme të kontrollit të sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të argumentojë rëndësinë e metodave agroteknike dhe të integruara në kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në frutikulturë;
- Të shpjegojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes, seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjes e magazinimit të produkteve të pemëve frutore, ullinje dhe agrumeve;
- Të shpjegojë ndikimin e dukurive ekstreme klimatike në prodhimin bujqësor.

b) Vreshtari

- Të përshkruajë faktorët klimatikë dhe tokësorë që ndikojnë në zhvillimin e hardhisë;
- Të shpjegojë klasifikimin botanik dhe ekonomik të hardhisë dhe të bëjë dallimin midis tyre;
- Të shpjegojë mënyrat e shtimit tek hardhia (me farë, vegetative);
- Të argumentojë domosdoshmërinë e prodhimit të fidanëve antifilokserikë;
- Të përshkruajë parimet mbi të cilat mbështetet ngritja e vreshtit mëmë antifilokserik;
- Të shpjegojë etapat e teknologjisë së fidanëve të shartuar dhe shërbimet kryesore që bëhen në vreshtin mëmë antifilokserik;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së tokës dhe shartesave për mbjellje;
- Të rendisë mënyrat e mbjelljes të shartesave dhe shërbimet në shartesore;
- Të analizojë veçoritë e krijimit të vreshtit të ri;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së tokës përpara mbjelljes së hardhisë;
- Të rendisë mënyrat, kohën, thellësinë e mbjelljes, si dhe shërbimet në vreshtat e rinj;

- Të shpjegojë qëllimin, rëndësinë dhe bazat teorike të krasitjes;
- Të analizojë sistemet e krasitjes tek hardhia dhe fazat përkatëse (formuese, prodhuese dhe ripërtëritëse) tek hardhia;
- Të argumentojë rëndësinë e shërbimeve agroteknike në vreshtari;
- Të përshkruajë sëmundjet më të përhapura të hardhisë si dhe masat e kontrollit të tyre;
- Të përshkruajë dëmtuesit kryesorë të hardhisë, si dhe masat e kontrollit të tyre;
- Të shpjegojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes, seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjes e magazinimit të produkteve të pemëve frutore, ullinjve dhe agrumeve;
- Të dallojë kultivarët e rrushit për tavolinë, verë të bardhë, kuqe, për tharje dhe përdorime të tjera.

Prodhimi blegtoral dhe kujdesi për kafshët

- Të shpjegojë rëndësinë ekonomike të prodhimit blegtoral sipas llojeve të kafshëve;
- Të shpjegojë rëndësinë rregullave higjieno-sanitare brenda dhe jashtë fermave blegtorale;
- Të shpjegojë rëndësinë e higjienës së përgjithshme të tufës, vendqëndrimit dhe procedurat e pastrimit të tij;
- Të shpjegojë rolin e ujit, higjienës së tij dhe të enëve, baseneve apo enëve të tjera ujë-pirëse.
- Të shpjegojë parimet dhe kriteret për ngritjen e strehimeve të kafshëve;
- Të përshkruajë rëndësinë e strehimit dhe mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;
- Të përshkruajë ndërtimin anatomik dhe funksionet e sistemeve dhe aparateve të organizmit të kafshës;
- Të shpjegojë fazat e ciklit seksual, pjekurisë seksuale dhe jetës ekonomike;
- Të shpjegojë kalendarin ndërzim–pjellje-tharje të tufës;
- Të përshkruajë sjelljen (etologjinë) e kafshëve në situata të veçanta;
- Të përshkruajë tipet dhe llojet e mbarështimit të kafshëve dhe shpendëve;
- Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të akuakulturës në vend;
- Të shpjegojë teknikat e rritjes së peshkut dhe midhjes;
- Të përshkruajë mënyrat e riprodhimit të peshqve dhe midhjeve;
- Të shpjegojë mënyrat e ushqimit të peshqve dhe midhjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e monitorimit të parametrave të ujit në mirë-rritjen e peshqve dhe midhjeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të bletarisë;
- Të shpjegojë teknikat e rritjes dhe kujdesit të bletëve;
- Të përshkruajë mënyrat e shtimit të bletëve;
- Të rendisë disa nga përkujdesjet e veçanta që kërkojnë bletët në fazën e shumimit të tyre;
- Të përshkruajë fazat e maturimit të mjaltit për përcaktimin e kohës së vjeljes së tij;
- Të dallojë llojet (kategoritë) e ushqimeve, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;

- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit të gjedhit;
- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit intensiv dhe ekstensiv të derrave;
- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit të njëthundrakëve (kuaj, gomerë, mushka);
- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit të të imtave;
- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit të shpendëve për vezë dhe për mish;
- Të shpjegojë mënyrat e të ushqyerit e të porsalindurve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit në raste patologjie;
- Të listoje masat profilaktike dhe zooteknike;
- Të respektojë legjislacionin e mirëqenies dhe të drejtës së kafshëve shtëpiake;
- Të përzgjedhë llojet e detergjentëve, dezinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar për enët, makinat mjelëse apo sipërfaqe të tjera dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë procedurat e pastrimit të impianteve mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit;
- Të shpjegojë mënyrat e grumbullimit dhe ruajtjen e prodhimeve blegtorale.

Prodhimi biologjik (BIO) (organik)

- Të përshkruajë kërkesat kryesore të Ligjit Shqiptar për bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë metodat e analizimit të cilësive biologjike të tokës dhe teknikat e mostrimit;
- Të shpjegojë metodat që përdoren për ruajtjen e cilësive biologjike e mikrobiologjike të tokës;
- Të rendisë tipet e punimeve të tokës dhe teknikat e punimeve minimale në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë metodat për ruajtjen dhe treguesit e biodiversitetit në fermë;
- Të përshkruajë normat teknike të kërkuara për prodhimin bujqësor BIO;
- Të përshkruajë llojet e plehrave, teknikat e kompostimit dhe metodat e plehërimit organik në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë metodat e administrimit të pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë metodat dhe teknikat e prodhimit të farave dhe fidanëve në bujqësinë BIO;
- Të përshkruajë normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë BIO;
- Të listojë preparatet e lejuara për plehërimin dhe mbrojtjen e bimëve në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë teknikat e korrjes, kositjes dhe vjeljes në bujqësinë BIO;
- Të përshkruajë normat teknike të kërkuara për prodhimet blegtorale BIO;
- Të përshkruajë parametrat teknologjikë për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO;
- Të shpjegojë kushtet teknike të mbarështimit, mirëqenies dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe shpendëve për prodhime BIO;
- Të shpjegojë teknikat e trajtimit dhe metodat e ruajtjes së produkteve të pas vjeljes në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë çfarë përfaqësojnë logot e prodhimit BIO dhe rëndësinë e tyre;

- Të shpjegojë faktorët përcaktues të cilësisë së prodhimeve BIO;
- Të shpjegojë metodat e marketingut dhe kanalet e tregtimit në bujqësinë BIO;
- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit, përgatitjes dhe tregtimit të kërpudhave.

Përpunime të thjeshta të produkteve bimore dhe blegtorale

- Të argumentojë rëndësinë ekonomike të përpunimit së produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit të thjeshtë të produkteve të drithërave;
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit të thjeshtë të perimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë, mjetet dhe teknologjinë e përpunimit të bimëve vajore, si dhe të ruajtjes e ambalazhimit të produkteve të përpunuara;
- Të përshkruajë mënyrat e përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
- Të rendisë mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar;
- Të përshkruajë përbërjen kimike dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e qumështit;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e përpunimit të thjeshtë të qumështit, ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve dhe nënprodukteve të tij;
- Të shpjegojë mënyrat e përpunimit të thjeshtë të mishit, ruajtjes e ambalazhimit të produkteve të përpunuara;
- Të analizojë procesin e përpunimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së peshkut për konsum.

Komunikimi etik dhe profesional

- Të shpjegojë nevojën dhe aspektet kryesore të komunikimit profesional;
- Të përshkruajë llojet, rregullat dhe teknikat e komunikimit;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit me kolegët dhe eprorët;
- Të argumentojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një komunikim;
- Të shpjegojë komunikimin verbal dhe atë jo-verbal;
- Të përshkruajë rëndësinë mënyrën e plotësimit të dokumenteve shkresore sipas formateve të kërkuara;
- Të ilustrujë format dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të shpjegojë parimet e punës në grup dhe rëndësia e zbatimit të tyre;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë fetare, gjinore, racore, kombëtare, kulturore dhe të tjera në komunikimin me të tjerët;
- Të përshkruajë format e bashkëpunimit dhe komunikimit me të tretë;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë së duhur profesionale;
- Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimit e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve.

Sipërmarrja dhe edukimi për karrierë

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit (sociale dhe ekonomike) në krijimin e një shoqërie të qëndrueshme;
- Të shpjegojë kuptimin filozofik të kompanisë dhe misionin e saj në tregun e biznesit bujqësor;
- Të shpjegojë lidhjen dhe ndryshimin midis sipërmarrjes dhe menaxhimit;
- Të përshkruajë fazat e zhvillimit të biznesit bujqësor në kontekstin e globalizimit;
- Të përshkruajë strukturat, organizimin dhe funksionimin e një sipërmarrje të vogël;
- Të interpretojë rolin e etikës dhe sjelljes profesionale për një biznes bujqësor të suksesshëm;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti duke identifikuar burimet e nevojshme;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare;
- Të përshkruajë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të informacionit në një biznes bujqësor;
- Të shpjegojë format dhe parimet e marketingut në fermë;
- Të listojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;
- Të argumentojë detyrimet dhe të drejtat ndaj institucioneve ligjore;
- Të shpjegojë konceptet financiare kosto, TVSH (Tatim i Vlerës së Shtuar), taksë doganore, fitim bruto, fitim neto, tatim fitimi, kontributet shëndetësore dhe sociale, kredi, financim, konkurrencë, shpenzim, bilanc etj.;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të faturave apo dokumenteve të thjeshta financiare;
- Të përshkruajë elementët e përcaktimit të kostos dhe të çmimit;
- Të përshkruajë hapat për përgatitjen e një oferte të punimeve/shërbimit;
- Të përshkruajë mënyrën dhe rëndësinë e plotësimit dhe ruajtjes së dokumentacionit;
- Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të identifikojë tiparet dhe aftësitë menaxheriale të një sipërmarrësi të suksesshëm;
- Të përshkruajë mundësitë për vetëvlerësim të kompanisë.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë llojet e produkteve dezinfektuese, deratizuese dhe dezinfektuese dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë llojet e produkteve fitosanitare dhe normat e përdorimit në bujqësi;

- Të interpretojë saktë manualet përkatëse në përdorimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve;
- Të listojë llojet e mjeteve të ndihmës së parë dhe përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë veprimet e nevojshme që duhen kryer për të dhënë ndihmën e shpejtë për të dëmtuarin në punë;
- Të interpretojë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Të përshkruajë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Të përshkruajë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit sipas rregullores përkatëse;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e përdorimit të kufizuar të pesticideve në ruajtjen e tokës nga ndotjet kimike;
- Të përshkruajë mënyrat e asgjësimit të mbetjeve shtazore;
- Të përshkruajë përdorimin racional të burimeve ujore;
- Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen e mbeturinave sipas llojit;
- Të shpjegojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisin.

Automatizim dhe TIK në bujqësi

- Të përshkruajë sistemet e automatizimit dhe robotikës në bujqësi;
- Të përshkruajë sistemet e digjitalizimit të proceseve në bujqësi;
- Të përshkruajë programet kryesore digjitale për menaxhimin e fermës (robotët, dronët, softuerë, internet, sensorët e temperaturës dhe lagështisë, imazhet ajrore dhe teknologjitë GIS dhe GPS, etj.);
- Të përshkruajë programet kryesore digjitale për informacionin e tokës bujqësore;
- Të përshkruajë programet kryesore digjitale për menaxhimin e makinerive;
- Të përshkruajë programet kryesore digjitale për monitorimin e lagështisë së tokës dhe përmbajtjen e lëndëve ushqyese në tokë;
- Të identifikojë llojet dhe përdorimin e pajisjeve të automatizuara për monitorimin e kushteve agrometeorologjike dhe hidrologjike (temperatura, lagështia e ajrit, lagështia e tokës, prania e CO₂).
- Të identifikojë llojet dhe përdorimin e pajisjeve të automatizuara dhe sensorëve në distancë për të planifikuar ujitje më efikase;
- Të identifikojë llojet dhe përdorimin e pajisjeve të automatizuara për plehërimin e bimëve;
- Të përshkruajë llojet e sensorëve në distancë për të përcaktuar indeksin e shëndetit të bimëve;
- Të përshkruajë llojet e sensorëve në distancë për të përcaktuar kohën e vjeljes;
- Të përshkruajë llojet e sensorëve në distancë për të bërë parashikime të prodhimit;

- Të identifikojë llojet dhe përdorimin e pajisjeve të automatizuara për ushqyerjen, parametrat shëndetësore dhe mjeljen e kafshëve;
- Të përshkruajë llojet e sensorëve për monitorimin e parametrave duke përfshirë ata mikroklimatikë në stallë;
- Të përshkruajë programet kryesore digjitale për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë.

Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore në ferma

- Të përshkruajë kërkesat kryesore të legjislacionit bujqësor që lidhet me cilësinë e prodhimeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e standardeve ndërkombëtare në cilësinë e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale (ISO, Global GAP, HACCP etj.);
- Të përshkruajë metodologjitë për vlerësimin e cilësisë të proceseve prodhuese bujqësore dhe blegtorale;
- Të përshkruajë metodat, kriteret dhe teknikat që përdoren për vlerësimin e cilësisë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të shpjegojë teknikat e ndarjes së produkteve bujqësore e blegtorale sipas cilësisë;
- Të shpjegojë normat teknike të përdorimit të input-eve në bujqësi sipas kulturave dhe karencën e produkteve të mbrojtjes së bimëve;
- Të shpjegojë normat e përdorimit të shtuesve (aditivë ushqimorë) në të ushqyerit e kafshëve dhe të shpendëve;
- Të shpjegojë kushtet teknike që duhen për ruajtjen e cilësisë së produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të shpjegojë standardet e cilësisë së ujit që përdoret në fermë sipas destinacionit të përdorimit;
- Të përshkruajë sistemet dhe kriteret e vlerësimit të cilësisë të mjedisit të fermës;
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve të përshtatshme ekologjike dhe rëndësinë e përdorimit të tyre për sigurimin e cilësisë së produktit.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Organizimi dhe menaxhimi i prodhimit bujqësor

- Të identifikojë zhvillimet në fushën e bujqësisë;
- Të zbatojë kuadrin rregullator në fushën e bujqësisë;
- Të planifikojë burimet njerëzore sipas proceseve të punës në bujqësi;
- Të zbatojë planin e qarkullimit të kulturave bujqësore;
- Të organizojë veprimtarinë në prodhimin bujqësor;

- Të mbikëqyrë proceset e punës në bujqësi;
- Të hartojë planin e prodhimit të fermës;
- Të planifikojë burimet materiale dhe financiare për proceset e punës në bujqësi;
- Të përcaktojë radhën e punës në përputhje me planifikimet e kryera të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;
- Të organizojë përgatitjen dhe sistemimin e vendit të punës, materialeve, mjeteve dhe pajisjeve të punës për proceset bujqësore të planifikuara;
- Të përdorë dokumentacionin teknik në fushën e bujqësisë;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të monitorojë zbatimin e planit të prodhimit në fermë;
- Të raportojë në mënyrë periodike mbarëvajtjen e veprimtarisë bujqësore.

Mirëmbajtje dhe riparim i makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve në bujqësi

- Të zbatojë rregullat e higjienës së makinerive dhe pajisjeve në bujqësi;
- Të kryejë kontrollin teknik dhe konfigurimin e nevojshëm të makinerive mjeteve të punës dhe pajisjeve;
- Të demonstrojë mënyrën e përdorimit të mjeteve të punës dhe pajisjeve për përpunime të thjeshta të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të zbatojë kalendarin e shërbimeve të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të kryejë të gjitha llojet e shërbimeve duke zbatuar teknikat e mirëmbajtjes sipas llojit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të zbatojë procedurat për ruajtjen dhe magazinimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve gjatë kohës që nuk përdoren;
- Të kryejë dezinfektimin e mjeteve, pasjeve bujqësore dhe blegtorale;
- Të identifikojë defekte të thjeshta në makineri, mjete pune dhe pajisje bujqësore dhe blegtorale;
- Të kryejë riparime të thjeshta në makineri, mjete pune dhe pajisje bujqësore dhe blegtorale;
- Të kryejë regjistrimin e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve sipas proceseve të punës;
- Të zbatojë teknikat e kolaudimit të makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjeve sipas proceseve të punës.

Mekanizimi në prodhim bimor

- Të përzgjedhë llojet e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjet në bazë të procesit të punës;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për punimin bazë të tokës;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për punime përgatitore të tokës për mbjellje;

- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për mbjellje;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për shërbimet agroteknike;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për vjelje, korrje, shirje dhe kositje;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për grumbullim dhe transport;
- Të përdorë makineritë bujqësore, mjetet e punës dhe pajisjet për përpunim paraprak të prodhimit bimor;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për seleksionim, ambalazhim, dhe ruajtjes e magazinim të produkteve të kulturave perimore.

Mekanizimi në prodhim blegtoral

- Të përzgjedhë llojet e makinerive, mjeteve të punës dhe pajisjet në bazë të procesit të punës;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për pastrimin dhe higjienizimin e komplekseve blegtoriale;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për higjienizimin dhe mirëmbajtjen e kafshëve;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për grumbullimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit blegtoral;
- Të përdorë mjetet e punës dhe pajisjet për fiksimin e kafshëve;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për mjeljen e kafshëve;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet në parkun e bletëve;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për kultivimin e peshkut dhe midhjes;
- Të përdorë makineritë, mjetet e punës dhe pajisjet për grumbullim dhe transport të prodhimit blegtoral.

Kushtet agropedologjike dhe klimatike për prodhimin bujqësor

- Të vlerësojë llojet e tokave dhe karakteristikat e tyre;
- Të respektojë procedurat e marrjes së mostrave të tokës dhe ujit, sipas teknikave të mostrimit;
- Të vlerësojë rezultatet e analizave fiziko-kimikë dhe biologjikë të tokës dhe të ujit;
- Të analizojë të dhënat agrometeorologjike gjatë planifikimit të prodhimit bujqësor;
- Të analizojë të dhënat agropedologjike gjatë planifikimit të prodhimit bujqësor;
- Të përzgjedhë llojet dhe varietetet e kulturave bujqësore për kultivim sipas kushteve agrometeorologjike, hidrologjike dhe agropedologjike;
- Të planifikojë prodhimin blegtoral sipas kushteve klimatike;
- Të zbatojë masat për parandalimin e ndikimit të kushteve të pafavorshme agrometeorologjike;

- Të zbatojë masat e përshtatshme në procesin e prodhimit për shkak të ndryshimeve klimatike;
- Të zbatojë teknikat e sistemimit dhe kullimit të tokave.

Prodhimi i kulturave perimore dhe bimëve të arave

a) Kultura perimore

- Të përcaktojë llojet e kulturave perimore sipas teknologjive të kultivimit të tyre;
- Të përzgjedhë kulturat perimore sipas kushteve klimatiko-tokësore;
- Të zbatojë teknikat dhe mënyrat e shtimit të kulturave perimore;
- Të zbatojë kriteret dhe procedurat për ndërtimin e mjediseve të mbrojtura (vllaja, shtretër, tunele, serra);
- Të demonstrojë mënyrat e përgatitjes dhe dezinfektimit të dherishtes;
- Të zbatojë mënyrat e punimit dhe përgatitjes të tokës;
- Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të kulturave perimore;
- Të zbatojë masat e kujdesit të bimëve në përputhje me teknologjitë e kultivimit të kulturave perimore në mjedise të mbrojtura ose në fushë;
- Të zbatojë teknologjitë e reja të kultivimit hidroponik, aeroponik dhe akuaponik;
- Të zbatojë procedurat e përdorimit të kufizuar të pesticideve për ruajtjen e tokës nga ndotjet kimike;
- Të përdorë plehrat organikë dhe plehërimin e gjelbër për kultivimin e kulturave perimore;
- Të kryejë plotësimin e nevojave ushqyese të bimëve sipas kërkesave;
- Të demonstrojë teknikat e shartimit të kulturave perimore;
- Të identifikojë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të kulturave perimore;
- Të zbatojë metodat agroteknike për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të përcaktojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes sipas llojit të kulturave;
- Të zbatojë teknikat e seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjes e magazinimit të produkteve të kulturave perimore.

b) Bimët e arave

- Të përzgjedhë bimët e arave sipas veçorive teknologjike të kultivimit dhe kushteve klimatiko-tokësore;
- Të zbatojë mënyrat e punimit dhe përgatitjes të tokës;
- Të përzgjedhë kultivarët e përshtatshëm sipas destinacionit të përdorimit në bujqësi;
- Të zbatojë teknologjinë e kultivimit të bimëve të arave;
- Të zbatojë masat e kujdesit të bimëve të arave në përputhje me teknologjitë e kultivimit të tyre në mjedise të mbrojtura ose në fushë;

- Të zbatojë procedurat e përdorimit të kufizuar të pesticideve në ruajtjen e tokës nga ndotjet kimike;
- Të përdorë plehrat organike në kultivimin e drithërave;
- Të kryejë plotësimin e nevojave ushqyese të bimëve të arave sipas kërkesave;
- Të identifikojë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë të bimëve të arave;
- Të zbatojë metodat e ndryshme agroteknike për kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të përcaktojë kohën, mënyrën, teknikën e vjeljes sipas bimëve të arave;
- Të zbatojë teknikën e seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjen e magazinimit të produkteve të bimëve të arave;
- Të zbatojë teknologjitë e kultivimit dhe manipulimit të bimëve mjekësore dhe aromatike;
- Të zbatojë teknologjitë e kultivimit të bimëve zbukuruese dhe luleve.

Prodhimi i bimëve shumëvjeçare

a) Frutikulturë

- Të përzgjedhë mënyrën e shtimit me farë dhe me pjesë vegetative;
- Të demonstrojë teknikën e shtimit natyror dhe artificial në frutikulturë;
- Të zbatojë procedurat për ngritjen e plantacioneve në përputhje me standardet dhe teknologjinë e prodhimit
- Të demonstrojë teknikën e ndryshme të shartimit në kulturat drufrutore;
- Të organizojë sektorin e shtimit dhe formimit të kulturave drufrutore;
- Të ngrejë fidanishten sipas kushteve klimatike dhe teknologjike;
- Të zbatojë hapat teknologjikë të kultivimit në drufrutorë;
- Të mbikëqyrë zbatimin e shërbimeve agroteknike në drufrutorë;
- Të mbikëqyrë zbatimin e përdorimit të kufizuar të herbicideve, pesticideve në ruajtjen e tokës nga ndotja kimike;
- Të zbatojë teknikën e plehërimit organik, mineral dhe të gjelbër në drufrutorë;
- Të zbatojë teknikën e krasitjes së drufrutorëve;
- Të zbatojë teknikën e krasitjeve të ullinjve dhe agrumeve;
- Të zbatojë masat për parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të marrë masa mbrojtëse në raste të dukurive ekstreme klimatike;
- Të vlerësojë dëmin e shkaktuar nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm;
- Të zbatojë metodat e ndryshme të kontrollit të sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të zbatojë metodat agroteknike dhe të integruara në kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në frutikulturë;
- Të përcaktojë kohën, mënyrën, teknikën e vjeljes së drufrutorëve;
- Të zbatojë teknikën e seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjen e magazinimit të pemëve frutore, ullinjve dhe agrumeve;

- Të marrë masat e duhura për të kufizimin e ndikimit të dukurive ekstreme klimatike në prodhimin bujqësor.

b) Vreshtari

- Të zbatojë mënyrat dhe teknikat e shtimit tek hardhia (me farë, vegjetative);
- Të ngrejë vreshtin mëmë antifilokserik sipas kriterëve të nevojshme;
- Të zbatojë teknikat e prodhimit të fidanëve antifilokserik;
- Të mbikëqyrë zbatimin e shërbimeve agroteknike në vreshtin mëmë antifilokserik;
- Të mbikëqyrë mënyrën e përgatitjes së tokës dhe shartesave për mbjellje;
- Të zbatojë mënyrat e mbjelljes të shartesave dhe shërbimet në shartesore;
- Të zbatojë teknikat e shartimit duke përdorur nënshartesat antifilokserike;
- Të përzgjedhë tokën për ngritjen e vreshtit;
- Të mbikëqyrë mënyrën e përgatitjes së tokës përpara mbjelljes së fidanëve;
- Të përcaktojë mënyrat, kohën, thellësinë e mbjelljes, si dhe shërbimet në vreshtat e rinj;
- Të zbatojë sistemet dhe teknikat e krasitjes tek hardhia;
- Të mbikëqyrë zbatimin e shërbimeve agroteknike në vreshta;
- Të zbatojë masat parandaluese të sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të identifikojë sëmundjet e hardhisë duke zbatuar masat e kontrollit të tyre;
- Të identifikojë dëmtuesit kryesorë të hardhisë duke zbatuar masat e kontrollit të tyre;
- Të mbikëqyrë zbatimin e planit të masave të kontrollit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të hardhisë;
- Të përcaktojë kohën, mënyrën, teknikat e vjeljes së vreshtit;
- Të zbatojë teknikat e seleksionimit, ambalazhimit, transportimit dhe ruajtjes e magazinimit të produkteve të rrushit.

Prodhimi blegtoral dhe kujdesi për kafshët

- Të përzgjedhë llojet dhe racat e kafshëve për prodhimin blegtoral sipas drejtimit ekonomik të tyre;
- Të zbatojë rregullat higjieno-sanitare brenda dhe jashtë fermave blegtorale;
- Të kryejë pastrimin e trupit të kafshës dhe të vendqëndrimit të tyre ;
- Të kontrollojë treguesit fiziko-kimik të ujit të pijshëm për kafshët dhe shpendët (shijen, ngjyrën, temperaturën, qartësinë, pH etj.);
- Të plotësojë nevojat për ujë të kafshëve/shpendëve në një fermë blegtorale;
- Të zbatojë kriteret për ngritjen e strehimeve të kafshëve sipas llojit, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;
- Të kryejë monitorimin e mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;
- Të përcaktojë moshën dhe peshën e përshtatshme për riprodhim në të gjitha llojet e kafshëve të fermës;

- Të zbulojë shenjat e afshit në kafshë të ndryshme me metodën e vrojtimit;
- Të analizojë sjelljen (etologjinë) e kafshëve në situata të veçanta;
- Të përzgjedhë llojet e peshqve në përputhje me kushtet e rritjes;
- Të zbatojë teknikat e rritjes së peshkut dhe midhjes;
- Të zbatojë masat profilaktike në ambientet e rritjes së peshqve dhe të midhjeve;
- Të kryejë shërbimet e nevojshme në shtimin e bletëve;
- Të zbatojë teknikat e shtimit, rritjes dhe kujdesit të bletëve;
- Të zbatojë masat profilaktike në koshere dhe parkun e bletarisë;
- Të realizojë përgatitjen e ushqimit artificial të bletëve sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të përzgjedhë dhe të mirëmbajë bazën materiale të bletarisë;
- Të përcaktojë kohën për vjeljen e mjaltit;
- Të vlerësojë cilësinë e ushqimeve me anë të prekjes, nuhatjes dhe ngjyrës;
- Të kryejë procese pune të përgatitjes të ushqimeve për blegtorinë (bar i thatë, silazh etj.) me krahë ose makineri;
- Të transportojë ushqimet nga magazina në stallë sipas llojit të ushqimit;
- Të kryejë ndarjen racionale të ushqimit për kafshët sipas llojit, kategorive, gjendjes fiziologjike-patologjike dhe drejtimit ekonomik të tyre;
- Të kryejë të ushqyerit e shpendëve sipas moshës dhe drejtimit ekonomik;
- Të monitorojë kullotjen e lirë të kafshëve në kullota ose të ushqyerit me regjim stallor;
- Të mbikëqyrë pastrimin, larjen dhe masazhimin e gjirit para mjeljes;
- Të monitorojë procesin e mjeljes së kafshëve;
- Të zbatojë planin e masave profilaktike në rast të një sëmundje infektive sipas udhëzimeve të specialistit;
- Të kryejë dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizimin e stallave dhe mjedisit në fermën blegtorale;
- Të mbikëqyrë procese pune për pastrimin e lëkurës së trupit, gjirit të kafshëve dhe pastrimin e thundrave;
- Të mbikëqyrë procesin e qethjes në dhen;
- Të mbikëqyrë transportin e plehut organik me mjete ose pajisje të duhura për në plehërishte;
- Të zbatojë masat higjienike gjatë mjeljes, transportit dhe ruajtjes të qumështit.

Prodhimi biologjik (BIO)

- Të respektojë kërkesat kryesore të Ligjit Shqiptar dhe standardet për bujqësinë BIO;
- Të gjykojë rezultatet e analizave për cilësitë biologjike të tokës;
- Të zbatojë metodat dhe teknikat për ruajtjen e cilësive biologjike e mikrobiologjike të tokës;
- Të përdorë teknikat e punimeve minimale të tokës në bujqësinë BIO;
- Të respektojë metodat për ruajtjen biodiversitetit në fermë;

- Të respektojë normat teknike të kërkuara për prodhimin bujqësor BIO;
- Të përzgjedhë llojet e plehrave që përdoren në bujqësinë BIO;
- Të zbatojë teknikat e kompostimit dhe metodat e plehërimit organik në bujqësinë BIO;
- Të përdorë metodat e administrimit të pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë BIO;
- Të prodhojë fara dhe/apo fidanë me prejardhje organike sipas metodave dhe teknikave të bujqësisë BIO;
- Të respektojë normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë BIO;
- Të vlerësojë preparatet e lejuara për plehërimin dhe mbrojtjen e bimëve në bujqësinë BIO;
- Të përdorë teknikat e korrjes, kositjes dhe vjeljes në bujqësinë BIO;
- Të respektojë normat teknike për prodhimet blegtorale BIO;
- Të vlerësojë parametrat teknologjikë për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO;
- Të zbatojë kushtet teknike të mbarështimit, mirëqenies dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe shpendëve për prodhime BIO;
- Të respektojë teknikat e trajtimit dhe metodat e ruajtjes së produkteve të pas vjeljes në bujqësinë BIO;
- Të respektojë normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit në bujqësinë BIO;
- Të vlerësojë faktorët përcaktues të cilësisë së prodhimeve BIO;
- Të përdorë metodat e marketingut dhe kanalet e tregtimit në bujqësinë BIO.

Përpunime të thjeshta të produkteve bimore dhe blegtorale dhe ruajtja e tyre

- Të mbikëqyrë teknikat e pastrimit të produkteve bujqësore;
- Të zbatojë teknikat e përpunimit të thjeshtë të drithërave;
- Të zbatojë teknikat e përpunimit të thjeshta të perimeve;
- Të mbikëqyrë zbatimin e teknikave artizanale të përpunimit të produkteve bujqësore (reçel, komposto, fruta të thata, raki);
- Të përdorë mjetet dhe pajisjet e duhura për përpunimin e thjeshtë të produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Të zbatojë teknikat e përpunimit të bimëve vajore, si dhe të ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve të përpunuara;
- Të zbatojë teknikat e thjeshta të përpunimit të prodhimit foragjer si ushqim për blegtorinë;
- Të zbatojë mënyrat e ruajtjes së prodhimit foragjer të përpunuar;
- Të mbikëqyrë procesin e përpunimit të qumështit, ambalazhimit dhe ruajtjes së produkteve dhe nënprodukteve të tij;
- Të zbatojë teknikat e përpunimit të thjeshtë të mishit, ruajtjes e ambalazhimit të produkteve të përpunuara;
- Të mbikëqyrë procesin e përpunimit, ambalazhimit dhe ruajtjes së peshkut për konsum.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të zbatojë Kodin e etikës;
- Të zbatojë teknikat përkatëse komunikimin me kolegë dhe klientë;
- Të zbatojë teknikat dhe parimet e punës në grup;
- Të zbatojë teknikat e duhura për negociim dhe zgjidhjen së mosmarrëveshjeve;
- Të demonstrojë mendimin kritik;
- Të përdorë terminologjinë profesionale në komunikim;
- Të respektojë barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të respektojë format dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Sipërmarrje dhe edukim karriere në bujqësi

- Të përcaktojë fazat e zhvillimit të biznesit bujqësor në kontekstin e globalizimit;
- Të dallojë strukturat, organizimin dhe funksionimin e një sipërmarrje të vogël;
- Të zbatojë rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale për një biznes bujqësor të suksesshëm;
- Të hartojë një plan të thjeshtë biznesi;
- Të menaxhojë burimet njerëzore, materiale dhe financiare në një projekt biznesi;
- Të zbatojë metodat e vlerësimit dhe vetëvlerësimit të aftësive profesionale;
- Të zbatojë metodat e menaxhimit të informacionit në një biznes bujqësor;
- Të zbatojë format dhe parimet e marketingut në fermë;
- Të zbatojë kuadrin ligjor dhe detyrimet administrative në fushën e biznesit përkatës, si pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes së tij;
- Të zbatojë detyrimet dhe të drejtat ndaj institucioneve shtetërore;
- Të plotësojë fatura apo dokumente të thjeshta financiare;
- Të llogarisë elementet e përcaktimit të kostos dhe të çmimit;
- Të respektojë hapat për përgatitjen e një oferte të punimeve/shërbimit;
- Të plotësojë dhe ruajë dokumentacionin sipas formateve dhe rregullave të paracaktuara;
- Të demonstrojë tiparet dhe aftësitë menaxheriale të një sipërmarrësi të suksesshëm;
- Të identifikojë mundësitë për vetëvlerësim të kompanisë.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit

- Të respektojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes personale sipas rregullores;
- Të respektojë sinjalistikën (udhëzimet e shkruara) në mjediset e punës sipas rregulloreve përkatëse;
- Të zbatojë planin e evakuimit në raste emergjence sipas procedurës respektive;
- Të zbatojë rregullat e shpëtimit dhe mbrojtjes ndaj zjarrit në bujqësi sipas rregulloreve përkatëse;

- Të mbrojnë veten dhe të tjerët gjatë fiksimit të kafshëve;
- Të mbrojnë kafshët nga tortura dhe të sigurojnë mirëqenien e tyre;
- Të përzgjedhë llojet e mjeteve të ndihmës së parë;
- Të japë ndihmën e parë në rast aksidenti;
- Të raportojë sipas rastit te personat përgjegjës për mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të grupojë mbetjet sipas llojit dhe rrezikut të tyre për ndotjen e mjedisit;
- Të grupojë mbetjet mjekësore veterinarë/fitosanitare dhe të zbatojë rregullat kombëtare e lokale për asgjësimin e sigurt të tyre;
- Të realizojë largimin, përpunimin dhe përdorimin e përshtatshëm të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta (të mbetjeve ujore, bimore dhe shtazore);
- Të respektojë kohën e pezullimit (karencën) të produkteve fitosanitare;
- Të përdorë në mënyrë racionale burimet ujore për zhvillim të qëndrueshëm;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisin;
- Të respektojë protokollet e duhura në raste endemie dhe pandemie;
- Të zbatojë rregullat e higjienës personale dhe të pajisjeve mbrojtëse në punë;
- Të kontrollojë përdorimin e duhur të detergjenteve, dezinfektantëve dhe pastruesve për mbetjet organike në enët, makinat mjelëse apo sipërfaqe të tjera.

Automatizimi dhe TIK në bujqësi

- Të përdorë programet kryesore digjitale për menaxhimin e fermës (softuerë, internet, sensorët e temperaturës dhe lagështisë etj.);
- Të përdorë programet kryesore digjitale për informacionin e tokës bujqësore;
- Të përdorë pajisje të automatizuara për monitorimin e kushteve agrometeorologjike dhe hidrologjike (temperatura, lagështia e ajrit, lagështia e tokës, prania e CO₂).
- Të përdorë pajisjet e automatizuara dhe sensorët për të planifikuar ujitje më efikase;
- Të përdorë pajisjet e automatizuara për plehërimin e bimëve;
- Të përdorë pajisjet e automatizuara për ushqyerjen, matjen e parametrave shëndetësore dhe mjeljen e kafshëve;
- Të përdorë sensorët për monitorimin e parametrave mikroklimatikë në stallë;
- Të përdorë sensorët për të përcaktuar vendndodhjen e kafshëve në kullotë.

Sigurimi i cilësisë së prodhimeve bujqësore në ferma

- Të vlerësojë cilësinë duke zbatuar kërkesat kryesore të legjislacionit bujqësor për prodhimet bujqësore dhe blegtorale;
- Të vlerësojë cilësinë duke zbatuar kërkesat kryesore të standardeve ndërkombëtare (ISO, Global GAP, HACCP etj.) për prodhimet bujqësore dhe blegtorale;

- Të zbatojë metodologjitë për vlerësimin e cilësisë të proceseve prodhuese bujqësore dhe blegtorale;
- Të përcaktojë cilësinë duke zbatuar kriteret dhe teknikat e cilësisë për prodhimet bujqësore e blegtorale;
- Të respektojë teknikat e seleksionimit të produkteve bujqësore e blegtorale sipas cilësisë;
- Të respektojë normat teknike të përdorimit të input-eve në bujqësi sipas kulturave dhe karencën e produkteve të mbrojtjes së bimëve;
- Të respektojë normat e përdorimit të shtuesve (aditivë ushqimorë) në të ushqyerit e kafshëve dhe të shpendëve;
- Të respektojë kushtet teknike që duhen për ruajtjen e cilësisë së produkteve bujqësore e blegtorale;
- Të respektojë standardet e cilësisë së ujit që përdoret në fermë sipas destinacionit të përdorimit;
- Të përdorë llojet e ambalazheve të përshtatshme dhe ekologjike për sigurimin e cilësisë së produktit.
- Të respektojë standardet dhe kriteret për sigurimin e cilësisë në mjedisin e fermës.

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet;
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;

Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.

